



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 335, Datë 19.12.2022

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 119, DATË 24.05.2022
“MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “IRARBA ENERJJI” SH.P.K. PËR
TRANSFERIMIN E ASETEVE TË PALUAJTSHME NË FAVOR TË BANKËS SË
BASHKUAR TË SHQIPËRISË SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 dhe nenit 113 të ligjit nr. 144/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2073/3 prot., datë 14.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 24.05.2022 “Mbi kërkesën e shoqërisë “IRARBA ENERJJI” sh.p.k. për transferimin e asetëve të paluajtshme në favor të BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË sh.a.”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 119, datë 24.05.2022, vendosi:
 1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “IRARBA ENERJJI” sh.p.k. për transferimin e asetëve të paluajtshme në favor të BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË sh.a., me kusht që, brenda 3 muajve nga ky miratim, të depozitohet në ERE marrëveshjen e nënshkruar me bankën për këtë transferim të asetëve, përfshirë dhe lista e asetëve të paluajtshme, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre.
 2. Mosdepozitimi i dokumentacionit sipas përcaktimeve të pikës 1, e bën këtë miratim të pavlefshëm.
 3. Dhënia e miratimit nga ERE për transferimin e asetëve nuk e çliron shoqërinë “IRARBA ENERJJI” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e organeve të tjera, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
 4. Ky vendim është objekt rishikimi në çdo kohë nga ERE.
- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e sipërcituar me shkresën nr. 194//5 prot., datë 30.05.2022.

- Brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 119/2022, shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k. ka depozituar në ERE kontratat/marrëveshjet barrësuese përkatëse të nënshkruara me “BANKËN E BASHKUAR TË SHQIPËRISË” sh.a., por në to është përcaktuar vetëm vlera totale e aseteve dhe nuk është dokumentuar lista e detajuar e aseteve të paluajtshme, ku të përcaktohet vlera e secilit prej tyre.
- Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 119/2022, vlerësohet që t’i lihet detyrë që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e këtij vendimi të depozitohet në ERE informacion/dokumentacionin përkatës mbi listën e detajuar të aseteve të paluajtshme që i shërbejnë veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre, të cilat barrësohen në favor të BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË sh.a.
- Në nenin 53, pika 2 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar se *organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit*. Po ashtu në nenin 113 të KPA-së është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vetë organit, që ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 119, datë 24.05.2022, ndryshon si vijon:
 1. *Të miratojë kërkesën e shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË sh.a., me kusht që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e këtij vendimit, të depozitohet në ERE informacion/dokumentacionin përkatës mbi listën e detajuar të aseteve të paluajtshme që i shërbejnë veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre, të cilat barrësohen në favor të BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË sh.a.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI